



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2023:176547  
Datë: 30.05.2024  
Numri i dokumentit: 05760193

KPPP.nr.1305/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Ada Group” SHA me numër të biznesit 811373000 dhe me numër TVSH 330201997, me seli në Prishtinë me adresë në Rr.”Ahmet Krasniqi” Bll.C2-H1 Nr.4, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson F.H., kundër debitorit “Florenti” NPT, me numër unik identifikues 811305334 dhe me numër fiskal 600110720, me seli në Mitrovicë me adresë në Rr.”Shemsi Ahmeti”, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.216/23 të datës 27.07.2023 të nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Isa Shala me seli të zyrës në Prishtinë, jashtë seancës me datë 29.05.2024, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. REFUZOHET NË TËRËSI i pabazuar prapësimi i debitorit “Florenti” NPT, me numër unik identifikues 811305334 dhe me numër fiskal 600110720, me seli në Mitrovicë me adresë në Rr.”Shemsi Ahmeti”, i paraqitur kundër Urdhrit P.nr. 216/23 të datës 27.07.2023, të nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Isa Shala, dhe i njëjti Urdhër MBETET NË FUQI në tërësi.

**A r s y e t i m**

Përmbartuesi Privat, me Urdhrit Përmbartimor P.nr. 216/23 të datës 27.07.2023, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, e ka caktuar përmbartimin ndaj debitorit në bazë të dokumenteve të besueshme–faturave dhe atë: faturës me nr. 21-SHV01-001-5693 date 30.09.2021. faturës me nr. 21-

SHV01-001-5692 datë 30.09.2021, faturës me nr. 21-SHV01-001-4735 datë 19.08.2021, faturës me nr. 21-SHV01-001-3588 datë 01.07.2021, faturës me nr. 21-SHV01-001-3589 datë 01.07.2021, faturës me nr. 21-SHV01-001-4225 datë 29.07.2021, faturës me nr. 21-SHV01-001-3020 datë 02.06.2021, faturës me nr. 21-SHV01-001-3280 datë 16.06.2021. faturës me nr. 21-SHV01-001-2361 datë 28.04.2021, faturës me nr. 21-SHV01-001-167 datë 31.03.2021 faturës me nr. 21-SHV01-001-1334 datë 18.03.2021, faturës me nr. SHV01-001-1333 datë 18.03.2021 faturës me nr. 21-SHV01-001-2042 datë 14.04.2021, faturës me nr. 22-SHV01-001-922 datë 11.02.2022, faturës me nr. 22-SHV01-001-558 datë 28.01.2022 faturës me nr. 22-SHV01-001-574 datë 28.01.2022, faturës me nr. 21-SHV01-001-7407 datë 10.12.2021, faturës me nr. 21-SHV01-001-7408 datë 10.12.2021, faturës me nr. 21-SHV01-001-7579 datë 17.12.2021, faturës me nr. 21-SHV01-001-7785 datë 24.12.2021 faturës me nr. 21-SHV01-001-6830 datë 19.11.2021 faturës me nr. 21-SHV01-001-6850 datë 19.11.2021 date 19.11.2021, faturës me nr. 21-SHV01-001-6119 datë 22.10.2021, faturës me nr. 21-SHV01-001-5052 datë 02.09.2021, faturës me nr. 21-SHV01-001-5200 datë 09.09.2021, faturës me nr. 21-SHV01-001-6308 datë 29.10.2021, me të cilat ka detyruar debitorin që në emër të përmbushjes së obligimeve nga faturat më sipër, brenda afatit prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të urdhrorit, t'i paguajë kreditorit shumën prej 9,483.65 Euro, me kamatën referente si pjesë e kamatës ligjore (lartësinë e të cilës BQK e publikon në bazë të rregullt gjashtëmujore sipas Ligjit nr.05/L-110 për Kamatëvonesat në Transaksione Tregtare) duke e llogaritur nga data kur kërkesa është bërë e arritshme e deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.

Kundër urdhrorit të Përmbartuesit Privat, brenda afatit të rregullt ligjor debitori ka ushtruar prapësim për faktin se në rastin konkret faturat nuk janë të përshatshme si dokument përmbartimor sepse koha e detyrimit është e lidhur ngushtë me barazimin e obligimeve financiare të palëve. Tutje në prapësim ka shtuar se kreditori nuk ka përmbushur detyrimin e tij i cili ka qenë barazimi i saldove financiare dhe se i njëjti nuk ka treguar gatishmëri që në bashkëpunim me debitorin t'i përmbahet marrëveshjes së tyre të bashkëpunimit dhe t'i barazojnë obligimet e tyre financiare e si e tillë përbën shkelje të nenit 71.par 1.7 të Ligjit për Procedurën përmbartimore.

I ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorit, dhe të anulohet në tërësi urdhri përmbartimor i Përmbartuesit Privat.

Kreditori, në përgjigje në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit duke shtuar që përmbaruesi ka vepruar drejt dhe ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm-faturave ashtu siç parashihen me nenin 29 par.1 nen par.1.3. Tutje ka shtuar se para se të dërgojnë lëndën në procedurë përmbarimore, kanë kontaktuar disa herë me debitorin dhe se përfaqësuesi i të njëjtit nuk ka kundërshtuar borxhin e as faturat të cilat janë në origjinal të pranuar nga pala debitore për shërbimet e pranuar.

Lidhur me pretendimet e debitorit se kreditori nuk ka përmbushur detyrimin e tij i njëjti thekson se nuk ka pasur për obligim përmbushjen e ndonjë detyrimi dhe se për të ekzistuar një detyrim i tillë është dashur që të vërtetohet me dokument publik ashtu siç parashihet me dispozita ligjore.

Ka kërkuar nga gjykata që ta refuzojë në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit dhe ta lë në fuqi urdhrin përmbarimor.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi nga shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “*Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm*”, ndërkaq me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*”. Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “*Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.*”, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në shkresat e lëndës është evidentuar se kreditori i ka bashkëngjitur propozimit për përmbarim dokumentin e besueshëm-faturat në origjinal dhe me të gjitha elementet përmbajtjesore të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana

e debitorit, është përcaktuar koha e përmbushjes së detyrimit, të njëjtat janë dorëzuar në origjinal dhe janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, fakt ky i cili vërtetohet me nënshkrimin e debitorit andaj, në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së.

Nga sa u theksua më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit gjykata ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

### GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1305/23, me datë 29.05.2024

Gj y q t a r i

Alajdin Tërshnjaku

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.